



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019) dhe nenit 40 paragrafi 2 të Rregullores së Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar sipas lëndës së formuar pas denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK) në seancën e 84-të të mbajtur më 31.03.2023 ka miratuar sa vijon

### **VENDIM**

Denoncimi i regjistruar me numër 12-56/1 të datës 12.01.2021, kundër anëtareve të -----, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë për faktin se nuk ka pretendime të qarta apo indikacione për veprime të paligjshme apo të palejueshme të zyrtarëve në ushtrimin e kompetencave publike dhe detyrave zyrtare, përkatësisht personat e raportuar nuk janë persona zyrtarë.

Lënda me numër 12-56/1 të datës 12.01.2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

### **Arsyetim**

Më 12 janar 2021, një kërkesë u dorëzua nga një parashtrues i njohur për Anëtarët e Bordit Drejtues të ----- Federatës së RMV-së (-FM) dhe u formua lënda me numër 12-56/1 i datës 12 janar 2021..

Në denoncim, parashtruesi thekson se anëtarët e Bordit ----- në një mbledhje kanë marrë vendim për shpërndarjen e burimeve financiare në formë shpërblimi si rezultat i suksesit të arritur nga ----- Kombëtarja e RMV-së për kualifikim në Kampionatin Evropian.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja thekson se në rastin, pretendimet i referohen shpërndarjes së fondeve me vendim të Bordit Drejtues në përputhje me Statutin e Federatës ----- e cila është në përputhje me Ligjin për Shoqatat dhe Fondacionet dhe Ligjin për Sport.

Mjetet për të cilat është vendosur të ndahen nuk janë mjete nga Buxheti i RMV-së, dhe ----- Federata e Maqedonisë është e regjistruar në Regjistrin Qendror të RMV-së si shoqatë e qytetarëve, në pajtim me Ligjin për shoqata dhe fondacione. Bazuar në këtë, KSHPK-ja ka konstatuar se personat e raportuar nuk janë zyrtarë në kuptim të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, pas së cilës ka konstatuar se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

*Bazuar në sa më sipër/KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.*

Dorëzuar:

- parashtruesi i denoncimit

Përpiloi: Mr. K.Z

Miratoi: Mr V.G – anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHTETËRORE  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
Nënkryetar  
Katica Nikolovska